



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-Nr.19/2023¹
PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË PËR PËRCJELLJEN E TË
BURGOSURVE

¹Udhëzim Administrativ MD - Nr. 19/2023 për funksionimin e njësisë për përcjelljen e të burgosurve, i nënshkruar nga Ministrija e Drejtësisë më datë 26.12.2023

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 19 (paragrafi 5) të Ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren (QRK)-Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojcën 1 (pika 3), si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-Nr. 19/2023 PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË PËR PËRCJELLJEN E TË BURGOSURVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është funksionimi i Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve gjatë transportit jashtë institucioneve korrektuese.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve, Institucionet Korrektuese si dhe institucionet e tjera të autorizuara me ligj të cilat urdhërojnë transportin e të burgosurve.

KAPITULLI II FUNKSIONIMI I NJËSISË PËR PËRCJELLJEN E TË BURGOSURVE

Neni 3 Statusi i Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve

Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve është njësi e veçantë në kuadër të Departamentit për Siguri, Operativë dhe Transport të Burgosurve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 4

Kompetencat e Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve

1. Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve është përgjegjëse për zbatimin e urdhëresave dhe kërkesave të organeve kompetente për përcjelljen dhe shoqërimin e të burgosurve jashtë institucionit korrektues, si në:

- 1.1. Gjykata;
- 1.2. Prokurori;
- 1.3. Spitale;
- 1.4. Shikim të vendit të ngjarjes;
- 1.5. Transferime ndërmjet Institucioneve Korrektuese;
- 1.6. Përcjellje humanitare;
- 1.7. Përcjellje të tjera sipas nevojës.

2. Zyrtarët Korrektues të caktuar me detyrë në Njësinë e Përcjelljes së të Burgosurve janë përgjegjës për sigurinë e të burgosurve gjatë përcjelljes jashtë institucionit korrektues.

3. Zyrtarët Korrektues të caktuar me detyrë në Njësinë e Përcjelljes së të Burgosurve gjatë përcjelljes së të burgosurve janë të autorizuar të bartin armën zyrtare dhe pajisjet tjera të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Roli i Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve

Roli i Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve është që të mundësoj përcjelljen e të burgosurve jashtë Institucionit Korrektues në pajtim me urdhëresat dhe kërkesat e institucioneve kompetente duke u përkujdesur në mënyrë profesionale dhe efikase për sigurinë dhe mirëqenien e të burgosurve.

Neni 6

Përgjegjësitë e Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve

1. Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve është përgjegjëse për:

- 1.1. planifikimin, organizimin dhe përcjelljen e të burgosurve jashtë institucioneve korrektuese;
- 1.2. zbatimin e procedurave dhe objektivave të Njesisë;
- 1.3. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të ofruar një përcjellje humane dhe të sigurt për të burgosurit gjatë përcjelljes së të burgosurve;

- 1.4. sigurinë që automjetet me të cilat planifikohet të bëhet përcjellja e të burgosurve, në mënyrë që të njëjtat të jenë në gjendje teknike të mirë dhe të përshtatshme me ndriçim, ventilim, ngrohje, për kategoritë e të burgosurve dhe nevojave tjera specifike.
2. Të burgosurit gjatë përcjelljes i sigurohet ujë i pijshëm dhe ushqim nga Institucioni Korrektues.
3. Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve bashkëpunon me Institucionet Korrektuese, Policinë e Kosovës, Gjykatat, Prokuroritë dhe institucionet tjera relevante lidhur me përcjelljen e të burgosurve jashtë Institucioneve Korrektuese.
4. Vlerësimi i nivelit të rrezikshmërisë së të burgosurve para përcjelljes së të tyre jashtë Institucionit Korrektues bëhet në pajtim me rregullat dhe procedurat e brendshme të punës së Njesisë të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
5. Njësia siguron mbikëqyrjen efektive dhe menaxhon situatat emergjente gjatë përcjelljes së të burgosurve.

Neni 7

Planifikimi i përcjelljes së të burgosurve

Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve pas pranimit të urdhëresave apo kërkesave për përcjellje nga institucionet kompetente bënë shqyrtimin, analizimin dhe planifikon organizimin e përcjelljes duke autorizuar zyrtarët përgjegjës për përcjellje në Institucionin Korrektues përkatës.

Neni 8

Caktimi i zyrtarëve korrektues në Njësinë për Përcjelljen e të Burgosurve

1. Zyrtarët korrektues të Institucioneve Korrektuese përkatëse mund të caktohen në punë dhe detyra për përcjelljen e të burgosurve në pajtim me rregullat dhe procedurat e brendshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Njësia organizon trajnime adekuate për zyrtarët e caktuar për kryerjen e punëve dhe detyrave për përcjelljen e të burgosurve.
3. Zyrtarët korrektues të cilët caktohen për kryerjen e punëve dhe detyrave për përcjelljen e të burgosurve paraprakisht duhet të kalojnë testet fizike të organizuar nga Departamenti i Sigurisë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
4. Zyrtarët e caktuar për përcjelljen e të burgosurve vlerësohen në periudha të caktuara për gjendjen fizike përmes testeve përkatëse.
5. Zyrtari i cili nuk e kalon testin nga paragrafi 4 i këtij neni, lirohet nga punët dhe detyrat për përcjelljen e të burgosurve, dhe kthehet në punët dhe detyrat e mëparshme në institucionin përkatës korrektues.

Neni 9

Ekipet e Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve

1. Me qëllim të realizimit të planit për përcjelljen e të burgosurve, zyrtarët korrektues të caktuar për përcjelljen e të burgosurve përbejnë ekipin e Institucionit Korrektuese përkatës.
2. Ekipet për përcjelljen e të burgosurve janë të vendosura në:
 - 2.1. Qendrën Korrektuese Dubravë;
 - 2.2. Qendrën e Paraburgimit Prishtinë;
 - 2.3. Qendrën e Paraburgimit Gjilan;
 - 2.4. Qendrën e Paraburgimit Prizren;
 - 2.5. Qendrën e Paraburgimit Pejë;
 - 2.6. Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë;
 - 2.7. Burgu i Sigurisë së Lartë;
 - 2.8. Qendrën Korrektuese Lipjan;
 - 2.9. Qendrën Korrektuese për Femra Lipjan;
 - 2.10. Qendrën Korrektuese Smrekonicë.

Neni 10

Pajisjet e sigurisë

1. Zyrtarët e Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve gjatë përcjelljes së të burgosurit janë të autorizuar të bartin armën zyrtare dhe pajisjet tjera të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Zyrtarët e Njesisë në pajtim me autorizimin përkatës bartin armët zyrtare sipas legjislacionit në fuqi dhe pajisjet e sigurisë si në vijim:
 - 2.1. jeleku taktik;
 - 2.2. jeleku antiplumb;
 - 2.3. mjetet prangose (duke përfshirë prangat e sigurisë së lartë) dhe lidhëset e plastikës;
 - 2.4. sprej OC;
 - 2.5. shufra;
 - 2.6. radio lidhje;
 - 2.7. pajisje tjera të sigurisë të autorizuar për përdorim.

Neni 11
Automjetet për Përcjelljen e të Burgosurve

- 1.Njësia me qëllim të realizimit të përcjelljes së të burgosurve jashtë Institucionit Korrektues përdorë automjetet zyrtare të Shërbimit Korrektues të Kosovës të përcaktuara për përcjellje.
2. Njësia në raste të veçanta mund të përdorë edhe automjete tjera zyrtare të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 12
Udhëzuesit

Shërbimi Korrektues i Kosovës me qëllim të zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ dhe rregullimin e hollësishëm të procedurave të përcjelljes së të burgosurve nxjerr udhëzues të veçantë për përcjelljen e të burgosurve.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

26/12/2023